



METODOLOGJIA E TAKSAVE TË KYÇJES NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

3.0

Shtator 2020

Prishtinë

Përmbajtja

1	Hyrje	4
1.1	Qëllimi.....	4
1.2	Shtrirja-Fushëveprimi	4
1.3	Kërkesat Ligjore dhe Rregullative	4
2	Definicionet	5
3	Baza Rregullative	7
3.1	Rregulla për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut	7
3.2	Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	7
3.3	Kodi i Kyçjes	8
3.4	Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmetimit	8
4	Parimet e Llogaritjes së Taksave për kyçje.....	8
4.1	Definimi i llojit të Taksës për Kyçje	8
4.2	Përcaktimi i Taksës për Kyçje.....	8
4.3	Kufiri teknik dhe komercial ndërmjet palëve	9
4.3.1	Kufiri teknik dhe komercial OST – Gjenerator	9
4.3.2	Kufiri teknik dhe komercial OST – OSSH	10
4.3.3	Kufiri teknik dhe komercial KOSTT – Konsumatorët industrial.....	10
4.4	Kyçjet e përbashkëta	11
4.5	Raporti në mes të Tarifave SHST dhe Taksave të Kyçjes	12
4.6	Kyçjet Emergjente.....	12
4.7	Mirëmbajtja	12
4.8	Standardet e Kyçjes	12
4.9	Përgjegjësit e Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe Konsumatorit industrial apo Gjeneratorit 13	
4.10	Përgjegjësitë e Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe OSSH.....	14
4.11	Pranim – Dorëzimi i Aseteve të Reja të Transmetimit dhe Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës.....	15
5	Kostot Indikative.....	15
5.1	Bazat e Kostos.....	15
6	Procesi i Kyçjes	16
6.1	Diskutimet Preliminare dhe Studimet e Dizajnit	16
6.2	Taksa për Aplikim.....	16
6.3	Aplikimi për Kyçje	16
6.4	Taksa e Kyçjes	17
6.5	Taksa për Shërbime	18



6.6	Oferta për Kyçje	18
6.7	Marrëveshja për Kyçje	19
6.7.1	Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Kyçje	20
7	Çështjet e Implementimit.....	20
7.1	Trajtimi i barabartë.....	20
7.2	Konfidencialiteti.....	20
7.3	Refuzimi për Kyçje	20
7.4	Dështimi i Kyçjes.....	20
7.5	Përforcimi i Kyçjes (Rritja e kapacitetit)	21
7.6	Asetet e Paguara nga Donatorët	21
7.7	Kompensimi	21
7.8	Anulimi (Përfundimi) i Kyçjes.....	22
7.9	De-energizimi (deaktivizimi) i kyçjes dhe Dekomisionimi	22
7.10	Ankesat.....	22
	Shtojca 1:.....	23
	Shtojca 2: Forma e Aplikacionit për Kyçje	23
	Shtojca 3: Taksa për Aplikim, Taksa Standarde dhe Kostoja Inxhinierike.....	28
	Shtojca 4: Taksa për Shërbime	30
	Shtojca 5: Kostot indikative për Asetet e Reja të Transmetimit dhe Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës te mundshme	31

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 4</i>

1 Hyrje

1.1 Qëllimi

Dokumenti përcakton metodologjinë, për përlogaritjen e taksave (kostove, etj.) të kyçjeve të reja në Sistemin e Transmetimit dhe rritjen e kapacitetit në kyçjet ekzistuese.

1.2 Shtrirja-Fushëveprimi

Ky dokument trajton:

- Parimet e taksave për kyçjet e reja në rrjetin e transmetimit;
- Llogaritjen e **Taksës për Aplikim**;
- Mënyrën e llogaritjes së Taksës për mirëmbajtje;
- Format e ekzemplarëve ku caktohen pajisjet e nevojshme për kyçje dhe çmimet e aseteve (përfshirë koston e punëve, furnizimin dhe instalimin e linjave elektrike, sistemeve matëse) të kostove indikative, të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjes (në pikat hyrëse dhe dalje) të sistemit të transmetimit për të cilat mund të paguhen taksat për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë taksat indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto taksat do të llogariten;
- Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat kundrejt zgjerimit apo përforcimit të sistemit të transmetimit;
- Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat ku sigurimi i linjave elektrike apo impiantit që duhet të instalohet janë të kapacitetit më të madh se sa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
- Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e pikës së kyçjes nga sistemi i OST-së dhe largimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit**.
- Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OST-së për të refuzuar kyçjen në sistem, të cilat do të jenë objektive dhe teknikisht dhe ekonomikisht të arsyeshme.
- Përmbajtjen e **Ofertës për kyçje** dhe **Marrëveshjen për Kyçje**; dhe
- Procesin e zgjidhjes së ankesave.

Dokumenti nuk trajton çështjet e detajuara teknike që lidhen me standardet teknike të pajisjeve, operimit dhe planifikimit të kyçjeve të reja, etj – këto janë të mbuluara në Kodin e Kyçjes të Kodit të Rrjetit si dhe kodeve tjera teknike në fuqi.

1.3 Kërkesat Ligjore dhe Rregullative

Kjo metodologji bazohet në dispozitat e:

- Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084.

Metodologjia është përgatitur në harmoni me:

- Rregullën për Vendorsjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut;

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 5</i>

- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut si dhe taksave të kyçjes;
- Kodin e Rrjetit - Kodi i Kyçjes.

2 Definicionet

Termet dhe përkufizimet të cilat nuk janë të renditura më poshtë, janë të dhëna në Ligje, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, Rregullat e Tregut, Rregullën për Vendosijen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmisionit si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Termet e definuara:

Afati i fundit për Ofertë është numri i ditëve pas dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje**, brenda të cilave KOSTT - **Operatori i Sistemit të Transmetimit** duhet të dorëzoj **Ofertën për Kyçje**.

Aplikacioni për Kyçje është aplikacion i dorëzuar nga **Aplikuesi** për një kyçje të re apo rritje të kapacitetit të kyçjes së vjetër në Rrjetin e Transmetimit.

Aplikuesi (parashtruesi i kërkesës) do të thotë një person fizik apo juridik i cili i kërkon OST të bëjë kyçjen e re apo për të modifikuar kyçjen ekzistuese në sistemin e transmetimit.

Asetet e Reja të Transmetimit përfshijnë të gjitha asetet përkatëse prej kufirit të Aseteve ekzistuese të Sistemit të Transmetimit deri te kufiri me Palën Aplikuese.

Asetet Përforcuese të Infrastrukturës janë asetet e nevojshme për përforcim të rrjetit të transmetimit të domosdoshme për realizimin e kyçjes përkatëse.

Baza e Aseteve të Rregulluara janë të gjitha asetet e transmetimit për të cilat KOSTT është i lejuar të tarifoj përmes Tarifave SHST. **Baza e Aseteve të Infrastrukturës** janë asetet e transmetimit ku **Aplikuesi** duhet të kyçet.

Data e Kyçjes është data në të cilën Asetet e kyçjes janë apo konsiderohet të jenë plotësisht të kyçura në Rrjetin e Transmetimit dhe KOSTT është në gjendje të siguroj Kapacitetin për Kyçje.

Dizajni Bazik si pjesë kryesore e procesit të inxhinierisë është dizajni, që përgatitet nga ana e punë kryerësit në fazën fillestare të implementimit të projektit. Fokuset në krijimin e kornizës së përgjithshme për zbatimin e projektit dhe në konfigurimin e përgjithshëm të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**, skemat, diagramet dhe situacionet përkatëse dhe parametrat tjerë, që nevojiten për të definuar strukturën e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**.

Dizajni Detal si pjesë kryesore e procesit të inxhinierisë, është dizajni që përgatitet nga ana e punë kryerësit në fazën e implementimit të projektit. Bazohet në dizajnin bazik dhe fokusohet në përshkrimin detal dhe të qartë të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**, duke përfshirë skemat dhe diagramet e ndryshme, që më pastaj qojnë në prodhimin, ndërtimin, instalimin, komisionimin dhe futjen në operim të atyre asetëve.

Formulari i Aplikacionit për Kyçje është formë e aplikacionit për kyçje për gjenerator, ngarkesë, respektivisht konsumator sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të kësaj Metodologjie.

Jetëgjatësia e Aseteve është periudha e definuar e operimit të asetëve të transmetimit.

Kapaciteti i Kyçjes nënkupton kapacitetin elektrik të matur në MW i ofruar në aplikacionin për kyçje.

Marrëveshja për kyçje - marrëveshja ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe shfrytëzuesit të sistemit, që përshkruan procedurën e kyçjes dhe pagesës për kyçje, fillimin e kyçjes, mirëmbajtjen, operimin dhe përfundimin e kyçjes në sistem.

OSSH - nënkupton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

Kostoja Fillestare është një vlerësim i kostos së asetëve e bazuar në njohuritë e **KOSTT**-it për koston aktuale për blerjen, ndërtimin, instalimin, testimin, lëshimin në punë, dhe mbikëqyrjen e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**.

Kostoja për Kompensim janë kosto që paguhen nga **Aplikuesi** për pronarin e tokës, për qasje në tokë dhe për dëmet eventuale gjatë implementimit të projektit.

Kostot Inxhinierike janë kosto që paguhen nga **Aplikuesi** për **KOSTT** në lidhje me përgjegjësitë dhe aktivitetet për tenderim dhe ndërtim të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** dhe varësisht nga përgjegjësia si **Palë** përgjegjëse do të llogariten si:

- 1.5% e kostos së **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** kur **Aplikuesi** është **Pala** përgjegjëse për Kyçje,
- 5% e kostos së **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** kur **KOSTT** është **Pala Përgjegjëse për Kyçje**

KOSTT nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Kosovës.

Kyçje e Re është linjë, gjenerator, nënstacion, stabiliment shpërndarës i kyçur në Rrjetin e Transmetimit ekzistues në pikën/nyjën kyçëse e definuar me MVA në nivelin nominal të tensionit.

Kapaciteti Efektiv nënkupton kapacitetin total në secilën pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t'u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa cenuar kufizimet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin e lidhjes së shkurtër, kufijtë e tensionit apo kufijtë e stabilitetit.

Oferta për Kyçje është një ofertë për kyçje në Rrjetin e Transmetimit e dhënë nga **KOSTT** për palën aplikuese.

Pala Përgjegjëse për Kyçje është pala që mund të jetë **Aplikuesi** ose **KOSTT**, që merr përgjegjësitë e definuara sipas Nenit 4.9 të kësaj Metodologjie.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 7</i>

Pika e Kyçjes është pika e kyçjes fizike e një shfrytëzuesi të sistemit me sistemin e transmetimit.

Plani Zhvillimor i Transmetimit nënkupton dokumentin Plani afatgjatë Zhvillimor i Transmetimit i aprovuar nga ZRRE.

Studimi i Dizajnit paraqet një analizë të detajuar mbi mundësitë (opsionet) e kyçjes në rrjetin e transmetimit, të përgatitur nga **KOSTT** për një **Aplikues** pas dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje** nga ana e **Aplikuesit**.

Studimi i Fizibilitetit është studim i detajuar mbi çështjet teknike dhe ekonomike bazuar në kalkulimet teknike të projektit të caktuar. Ky studim do të realizohet nga një palë e kontraktuar për shkak të madhësisë dhe kompleksitetit të projektit.

Shfrytëzuesi i sistemit janë personat fizikë ose juridikë të cilët furnizojnë apo furnizohen përmes sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

Taksa për Aplikim është pagesa që kryhet në kohën kur aplikohet për kyçje, e cila mbulon shpenzimet për: **Studimin e Dizajnit** dhe/ose **Studimin e Fizibilitetit**, **Ofertën për Kyçje** dhe draftimin e **Marrëveshjes për Kyçje**. Gjatë diskutimeve fillestare me palën aplikuese para se të bëhet Aplikimi për Kyçje, **KOSTT** do të përcakton numrin e ditëve të nevojshme për procedimin e Aplikacionit.

Taksa për kyçje është taksa që do të paguhet nga Aplikuesi për kyçje në Rrjetin e Transmetimit

Taksë Standarde është taksa e miratuar nga **ZRRE** dhe publikuar në faqen elektronike të **KOSTT**-it në €/ditë, pjesë e këtij dokumenti për punët e kryera nga stafi i **KOSTT**-it për ti mbuluar **Kostot Inxhinierike**.

Vlera e Aseteve Ekuivalente Moderne (MEAV) është kostoja aktuale e zëvendësimit të asetit të transmetimit. Kjo përdoret në kalkulimin e tarifës për mirëmbajtje.

ZRRE nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji.

3 Baza Rregullative

3.1 Rregulla për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut

Kjo Rregull përcakton kushtet që aplikohen për kyçje. Bazuar në këtë, OST përcakton taksat për kyçje, definon elementet që do të përfshihen në përcaktimin e kostos së kyçjes, obligon që kjo metodologji të definojë kufirin në mes kostove që mbulohen nga taksat e kyçjes dhe kostove që mbulohen nga Tarifatat OST/OT.

3.2 Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

Rregulla përcakton kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji të konsumatorëve, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e kompanive energjetike dhe konsumatorëve. Përshkruan parimet e përgjithshme për kyçje dhe për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, matjen, leximin, grumbullimin e të dhënave, faturimin si dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 8</i>

3.3 Kodi i Kyçjes

Kodi i Kyçjes është pjesë e Kodit të Rrjetit dhe mbulon kërkesat inxhinierike dhe teknike të kyçjes. Gjithashtu kërkon nga **KOSTT** që të hartoj Metodologjinë e Taksave për Kyçje dhe të jap **Oferta për Kyçje**. Njëherit përcakton kufirin ndërmjet KOSTT-it dhe OSSH-së.

3.4 Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmetimit

Në aspektin e kyçjes Licenca obligon KOSTT-in të ofrojë kushtet për kyçje dhe përcaktimin e tarifave dhe taksave për kyçje dhe shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit. I licencuari do të sigurojë që procesi i trajtimit të aplikacioneve për kyçje në Rrjetin e Transmetimit do të jetë jo diskriminues dhe do të sigurojë që tarifat dhe taksat të:

- a) inkurajojnë konkurrencën në sektorin e energjisë dhe lehtësimin e hyrjes në tregun e energjisë, dhe
- b) jenë në përputhje me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut.

4 Parimet e Llogaritjes së Taksave për kyçje

4.1 Definimi i Llojit të Taksës për Kyçje

Të gjitha aplikacionet për kyçje në Sistemin e Transmetimit varësisht prej llojit të tyre dhe kushteve të paraqitura në këtë metodologji do të taksohen si “kyçje e thellë” apo “kyçje e cekët”. Këto kyçje përcaktohen si vijon:

- “Kyçje e thellë” nënkupton se **Aplikuesi** (parashtruesi i kërkesës) do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj kostot e asetëve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të transmetimit plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforsimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të pikës së kyçjes. Këtyre kostove ju shtohen dhe kostot tjera të përfshira në paragrafin 6.4 (Taksa e Kyçjes) të kësaj Metodologjie.
- Kyçje e “cekët” nënkupton se **Aplikuesi** (parashtruesi i kërkesës) do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj vetëm ato kosto që shkaktohen nga krijimi i një kyçjeje të re, në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të transmetimit të përcaktuar nga operatori i sistemit të transmetimit. Këtyre kostove ju shtohen dhe kostot tjera përkatëse (kostot në pikën 1 dhe 2) të përfshira në paragrafin 6.4 (Taksa e Kyçjes) të kësaj Metodologjie.

4.2 Përcaktimi i Taksës për Kyçje

- **Kyçja e Gjeneratorëve**

Aplikuesit për kyçje të gjeneratorit të ri dhe aplikuesit për rritje të kapacitetit të kyçjes për gjeneratorin ekzistues, duhet të paguajnë taksën për kyçje të thellë.

- **Kyçja e Ngarkesave**

Taksa e Kyçjes për aplikuesit e kategorisë së Ngarkesave do të caktohet si:

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 9</i>

a) kyçje e thellë, në rastin kur:

- i. ngarkesa e re apo rritja e ngarkesës tejkalon 3% të **Kapacitetit Efektiv** ekzistues në pikën e kyçjes në rrjetin e transmetimit.
- ii. kyçja nuk është paraparë në Planin Zhvillimor të Transmetimit,
- iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kyçjes së re e cila tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të OST/OT nga taksat përkatëse për kyçje.

b) kyçje e cekët, në rastin kur:

- i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë nuk tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e transmetimit, ose
- ii. kyçja parashihet në Planin Zhvillimor të Transmetimit,
- iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kyçjes e cila nuk tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të OST/OT nga taksat përkatëse për kyçje.

Kostot e punëve dhe të **Aseteve të Reja të Transmetimit**, të ndërlidhura me kyçjen e cekët, KOSTT do ti mbulon përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit (SHST).

Në pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit dhe praktikat më të mira inxhinierike, KOSTT do të vlerësoj nivelin e kërkuar të përforcimit të transmetimit për cilindo aplikacion për kyçje për të identifikuar shkallën e kostos së ndërlidhur të përforcimit.

4.3 Kufiri teknik dhe komercial ndërmjet palëve

Është kufiri që definon pronësinë e aseteve ndërmjet KOSTT-it dhe shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit dhe pikën matëse komerciale ndërmjet palëve. Varësisht prej kategorive të shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit dhe legjislacionin në fuqi përcaktohet dhe kufiri teknik. Pra, kjo nënkupton që kufiri do jetë i llojit të veçantë për Gjeneruesit, OSSH-në dhe Konsumatorët industrial.

4.3.1 Kufiri teknik dhe komercial OST – Gjenerator

4.3.1.1 Kufiri teknik në mes OST dhe Gjeneratorit është pika lidhëse:

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 10</i>

- a) Mes të sistemit të zbarave të tensionit të lartë dhe fushës transformatorike të transformatorit ngritës;
- b) Në rast se Gjeneratori shfrytëzon linjën e transmetimit për shpenzime vetanake, kufiri teknik në mes të OST dhe Gjeneratorit do të trajtohet sikurse si një konsumator industrial si në paragrafin 4.3.3.

4.3.1.2 Kufiri komercial është në përputhje me kufirin teknik në mes të OST dhe Gjeneratorit.

4.3.1.3 Në rastin kur Gjeneratori përbëhet nga një grup njësisht gjeneruese me licenca të veçanta dhe janë të kyçura në të njëjtën pikë kyçëse të transmetimit, atëherë përveç sistemeve matëse në kufirin teknik/komercial duhet të vendosen edhe sistemet matëse në dalje të secilës njësi të licencuar gjeneruese.

4.3.2 Kufiri teknik dhe komercial OST – OSSH

4.3.2.1 Kufiri teknik në mes OST dhe OSSH është pika lidhëse e:

- a) fushës transformatorike të transformatorëve energjetikë 220/35/10 (20) kV dhe 110/35/10(20) kV në zbarat 35 kV, 10(20) kV,
- b) fushës për shpenzime vetanake (35 kV, 10(20) kV) në zbarat e tensionit të mesëm 35 kV, 10(20) kV

Ndërsa zbarat, daljet e tensionit të mesëm duke përfshirë dhe fushat matëse i përkasin OSSH-së.

4.3.2.2 Kufiri komercial është në përputhje me kufirin teknik në mes të OST dhe OSSH-së.


4.3.3 Kufiri teknik dhe komercial KOSTT – Konsumatorët industrial

4.3.3.1 Kufiri teknik OST – Konsumatorë industrial është skaji fundor i izolatorëve zingjirë të lidhur për portalin fundor të linjave të transmetimit.

Në rastet kur konsumatori industrial dëshiron që përveç aseteve të definuara me kufirin ndarës të bartë në pronësi të KOSTT-it edhe asete tjera atëherë kjo do të përcaktohet në **Marrëveshjen për Kyçje** përmes një kapitulli të veçantë brenda saj.

4.3.3.2 Kufiri komercial është në përputhje me kufirin teknik në mes të OST dhe Konsumatorit Industrial.

Për një përkufizim më të qartë në figurën në vijim paraqitet kufiri teknik ndërmjet KOSTT dhe palëve përkatëse.



4.4 Kyçjet e përbashkëta

Në rastin kur në zbarra ka të kyçur gjenerator ose ngarkesë dhe kyçja e re e një gjeneratori apo ngarkese bëhet përmes një linje direkte, atëherë kufiri do të përcaktohet konform kufijve të përcaktuar në paragrafin 4.3.3, varësisht nga kategoritë e palëve për të cilat përcaktohen kufijtë. Kjo nënkupton që do të kemi dy pika të ndryshme të kufijve (teknik dhe komercial) ndërmjet **KOSTT** dhe **Palëve**. Në këtë rast kostot për vendosjen e sistemeve matëse shtese do të barten tek pala kyçëse e re.

Humbjet teknike për pjesën e rrjetit që e shfrytëzojnë të dy palët do të ndahen në bazë të sasisë të rrjedhave të energjisë elektrike të matur në njehsorët përkatës.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 12</i>

4.5 Raporti në mes të Tarifave SHST dhe Taksave të Kyçjes

Asetet e Reja të Transmetimit dhe Asetet Përforcuese të Infrastrukturës të paguara nga shfrytëzuesit e sistemit në pajtim me kufirin teknik ndërmjet palëve (paragrafi 4.3) dhe në pajtim me llojin e taksës për kyçje që zbatohet për palët, do të transferohen në pronësi të KOSTT. Në rastin e kyçjeve të nënstacioneve 110/x kV me transformatorët zbritës, çdo përmirësim i këtyre aseteve për të përmbushur rritjen e ngarkesës në sistemin e shpërndarjes nuk do të përfshihet në taksat e kyçjes përveç nëse taksat për kyçje të thellë duhet të aplikohen. Konditat e ngjashme do të zbatohen në qoftë se një nënstacion i ri ka kërkuar të furnizojë sistemin e shpërndarjes dhe për të cilin nuk kërkohet të bëhet përforsim i Rrjetit të Transmetimit si rezultat i rritjes së ngarkesës së pa planifikuar në sasi dhe kohë. Në këtë drejtim, është vërejtur se kërkesa për nënstacion të ri apo për rritje të kapacitetit të nënstacionit ekzistues në sistemin e shpërndarjes normalisht do të përfshihet në Planin Zhvillimor të Transmetimit.

Detaje tjera të metodologjisë së tarifave për SHST të KOSTT-it janë vendosur në Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit, Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut dhe Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të publikuara nga KOSTT.

4.6 Kyçjet Emergjente

Në rastet e rrethanave të paparashikuara është e nevojshme të sigurohet kyçje emergjente në Sistemin e Transmetimit (dmth. jashtë kornizës kohore të përcaktuar në Kodin e Kyçjes) atëherë do të aplikohen:

- Derogimi nga Kodi i Kyçjes, i cili aprovohet nga **ZRrE**;
- **KOSTT** do të jap vlerësimin adekuat të kostos;
- **Aplikuesi** do ta paguaj këtë vlerësim paraprakisht;
- Kostot aktuale do të përshtaten/rekonsiliohen pasi të realizohet kyçja emergjente.

4.7 Mirëmbajtja

Kostot e mirëmbajtjes për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe për **Asetet Përforcuese të Infrastrukturës** të shfrytëzuesit do të ngarkohen përmes tarifave të shfrytëzimit të sistemit të transmetimit (SHST).

Asetet e Reja të Transmetimit dhe Asetet Përforcuese të Infrastrukturës të financuara nga Gjeneratorët apo **Asetet e Reja të Transmetimit** të financuara nga Ngarkesa do të trajtohen si donacion për KOSTT-in. KOSTT ka të drejtë të bëjë kyçjen e shfrytëzuesve të rijë në këto asete, dhe do të aplikoj formën e kompensimit si në nenin 7.7 më poshtë.

4.8 Standardet e Kyçjes

Standardet e sigurisë të caktuara në **Ofertën për Kyçje** do të jenë në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe kërkesat tjera në Kodet Teknike përkatëse dhe praktikatat më të mira industriale.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 13</i>

4.9 Përgjegjësit e Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe Konsumatorit industrial apo Gjeneratorit

Aplikuesi në **Aplikacionin për Kyçje** do të theksoj **Palën Përgjegjëse për Kyçje** që do të jetë përgjegjëse për procesin e tenderimit dhe ndërtimit të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**. Kjo palë mund të jetë **Aplikuesi** apo **KOSTT-i**:

1) Nëse **Aplikuesi** është **Palë Përgjegjëse për Kyçje** atëherë:

- **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**;
- **Aplikuesi** përgatit dosjen e tenderit dhe shpall tenderin;
- **Aplikuesi** përzgjedh fituesin e tenderit, (**KOSTT** mund të merr pjesë në vlerësimin e ofertave);
- **Aplikuesi** do të paguajë koston tenderuese si dhe koston e kontratës;
- **KOSTT** merr përgjegjësinë për shqyrtimin dhe aprovimin e **Dizajneve Bazike** për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**;
- **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për furnizimin, ndërtimin dhe instalimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**;
- **KOSTT** bënë mbikëqyrjen e punëve ndërtimore dhe punëve instaluese elektrike dhe mekanike, bazuar në kushtet e lejes ndërtimore;
- **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për sigurimin e lejeve të nevojshme konform të gjitha ligjeve të Kosovës në fuqi ose **KOSTT** me kërkesë të aplikuesit përmes të një marrëveshje bilaterale mund të angazhohet që në emër të aplikuesit për implementimin e të gjitha procedurave konform ligjeve të Kosovës në fuqi për: sigurimin e lejeve përkatëse për Asetet e Reja të Transmetimit, për procedurat për shpronësim/servitut të pronave të paluajtshme të nevojshme për ndërtimin e asetëve të reja të transmetimit. Aplikuesi do të ngarkohet me taksën për shërbime. Lidhur me këto shërbime **KOSTT** nuk merr përgjegjësi për vonesat eventuale të shkaktuara nga procesi i shpronësimit dhe marrjes së lejeve përkatëse nga autoritetet shtetërore. Aplikuesi merr përgjegjësinë për realizimin e pagesave për kompensim të shpronësimit /servitutit të pronave të paluajtshme ku ndërtohen Asetet e Reja të Transmetimit.
- **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për kryerjen e të gjitha testeve të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** (testimet në fabrike dhe testimet në terren) në prezencën e **KOSTT-it**, ndërsa **KOSTT** merr përgjegjësinë për aprovimin e atyre testeve;
- **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për trajnimin e stafit të **KOSTT-it** në terren (në vendet ku montohen pajisjet) për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**.
- **Aplikuesi** merr përgjegjësinë e komisionimit, ndërsa **KOSTT** merr pjesë në mbikëqyrjen e komisionimit dhe bënë lëshimin në operim të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**;
- **Aplikuesi** paguan **Koston Inxhinierike** për **KOSTT-in**

2) Nëse **KOSTT** është **Palë Përgjegjëse për Kyçje** atëherë:

- **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**;

- **KOSTT** përgatit dosjen e tenderit dhe shpall tenderin;
- **KOSTT** dhe aplikuesi përzgjedhin fituesin e tenderit;
- **Aplikuesi** paguan koston e kontratës për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**, **KOSTT** merr përgjegjësinë për shqyrtimin dhe aprovimin e dizajneve bazike dhe detale për **Asetet e Reja te Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**
- **KOSTT** merr përgjegjësinë për sigurimin e lejeve të nevojshme për ndërtimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** konform ligjeve të Kosovës në fuqi. **KOSTT** nuk merr përgjegjësi për vonesat eventuale të shkaktuara nga procesi i shpronësimit dhe marrjes së lejeve përkatëse nga autoritetet qeveritare. Aplikuesi merr përgjegjësinë për realizimin e pagesave për kompensim të shpronësimit /servitutit të pronave të paluajtshme ku ndërtohen Asetet e Reja te Transmetimit.
- **KOSTT** merr përgjegjësinë për furnizimin, ndërtimin dhe instalimin, testimin, komisionimin dhe lëshimin në operim të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**,
- **Aplikuesi** paguan **Koston Inxhinierike** për **KOSTT**-in

4.10 Përgjegjësitë e Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe OSSH

- **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për **Asetet e Reja të Transmetimit**;
- **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushat e shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV dhe ia dorëzon OSSH-së për tenderim;
- **KOSTT** përgatit dosjen e tenderit, shpall tenderin dhe përzgjedhë fituesin e tenderit për **Asetet e Reja të Transmetimit** përveç fushave transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushave të shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV;
- **OSSH**-ja përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për Asetet e Reja te Shpërndarjes dhe ia dorëzon **KOSTT**-it për rishikim;
- **OSSH**-ja përgatit dosjen e tenderit, shpallë tenderin dhe përzgjedhë fituesin e tenderit për **Asetet e Reja të Shpërndarjes** duke përfshirë fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushat e shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV.
- **Asetet e Reja te Transmetimit** dhe Asetet e Reja te Shpërndarjes te cilat do te instalohen brenda nënstacionit duhet t'i plotësojnë standardet IEC, IEEE, ISO dhe duhet të jenë të prodhuesve më të njohur ndërkombëtarë;
- **KOSTT** do të paguajë koston tenderuese si dhe koston e kontratës për **Asetet e Reja të Transmetimit**. Pagesa për fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushat e shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV do të bëhet nga **KOSTT** tek **OSSH** konform politikave të brendshme të **KOSTT**;
- **OSSH** do të paguajë koston tenderuese si dhe koston e kontratës për Asetet e Reja të Shpërndarjes duke përfshirë edhe koston për fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushat e shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV;
- Transferimi i fushave transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushave të shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV nga **OSSH** në **KOSTT** do të bëhet menjëherë pas futjes në operim të nënstacionit;
- Plani dinamik i furnizimit, instalimit, komisionimit dhe lëshimit në operim të aseteve të reja të shpërndarjes duhet te jetë i harmonizuar me planin kryesor dinamik te furnizimit, instalimit, komisionimit dhe lëshimit në operim të **Aseteve të Reja të Transmetimit**.

- **KOSTT** merr përgjegjësinë për shqyrtimin dhe aprovimin e dizajneve bazike dhe detale për **Asetet e Reja të Transmetimit**.
- **KOSTT** merr përgjegjësitë për sigurimin e lejeve të nevojshme për **Asetet e Reja të Transmetimit** konform ligjeve të Kosovës në fuqi,
- **OSSH** merr përgjegjësinë për shqyrtimin dhe aprovimin e dizajneve bazike dhe detale për Asetet e Reja të Shpërndarjes, **OSSH** merr përgjegjësitë për sigurimin e lejeve të nevojshme për Asetet e Reja të Shpërndarjes konform ligjeve të Kosovës në fuqi,
- **KOSTT** merr përgjegjësinë për furnizimin, ndërtimin, instalimin, testimin, komisionimin dhe lëshimin në operim të **Aseteve të Reja të Transmetimit**. Për fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushave të shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV, **KOSTT** do të merr pjesë në komisionim dhe lëshim në operim. **OSSH** merr përgjegjësinë për furnizimin, ndërtimin, instalimin, testimin, komisionimin dhe lëshimin në operim të Aseteve të Reja të Shpërndarjes duke përfshirë fushat transformatorike 35, 10(20) kV dhe fushat e shpenzimeve vetanake 35, 10(20) kV

Është e mundur që të kemi më shumë se një **Palë Përgjegjëse për Kyçje**. Në atë rast do të aplikohet zgjidhje tjetër e bazuar në parimet e kësaj metodologjie.

Kur **OSSH** pranon një kërkesë nga ndonjë aplikues për kyçje në Rrjetin e Shpërndarjes në nivelin 35, 10(20) kV që ndërlidhen me asetet e transmetimit, atëherë **OSSH** është e obliguar që këtë aplikacion fillimisht ta shqyrtoj me **KOSTT** në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i atij aplikacioni në sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit transmetues.

Në rast se vlerësohet se ka ndikim negativ në sigurinë dhe besueshmërinë e Sistemit të Transmetimit, atëherë **KOSTT** do të kërkojë nga aplikuesi përforsim në rrjetin e transmetimit dhe si rezultat i kësaj për aplikuesin do zbatohet taksë për kyçje të thellë konform kësaj metodologjie.

4.11 Pranim – Dorëzimi i Aseteve të Reja të Transmetimit dhe Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës

Me përfundimin e ndërtimit **KOSTT** dhe **Aplikuesi**, do të bëjnë pranim-dorëzimin e asetëve përkatëse brenda kufirit **KOSTT – Aplikues**. Periudha garantuese e asetëve të dorëzuara nga **Aplikuesi** në **KOSTT** do të jete përgjegjësi e Aplikuesit.

5 Kostot Indikative

Ky seksion përcakton kostot indikative që mbulojnë **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**. Kostot indikative për **Asetet e Reja të Transmetimit** dhe **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** janë të detajuara në Shtojcën 5 të këtij dokumenti.

Përcaktimi i kostove indikative për **Asetet Përforcuese të Infrastrukturës** dhe **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** nuk është e mundur të bëhet pasi që këto ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme me madhësinë e ngarkesës, vendin dhe vitin e kyçjes.

5.1 Bazat e Kostos

Vlerësimi fillestar i kostove të kyçjes do të bazohet në njohuritë aktuale të **KOSTT**-it për blerjen dhe ndërtimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** të aplikueshme në Kosovë. Pas vlerësimit të përafërt të kostos së kyçjes, është përgjegjësi e **Aplikuesit** nëse dëshiron të vazhdojë apo jo procesin e kyçjes.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 16</i>

KOSTT për **Aplikuesin** do të nxjerrë një **Ofertë për Kyçje** brenda së cilës do të përfshihen kostot për kyçje për çdo tip të aseteve (**Asetet e Reja të Transmetimit** dhe **Asetet e Përforsimit të Infrastrukturës** (nëse është e nevojshme)).

Varësisht nga negociatat, oferta mund të përfshijë kushtet për pagesën e interesit për dështimin e secilës palë për të përfunduar pjesën e vet të punëve të nevojshme ose për të siguruar pëlqimet e nevojshme të cilat çojnë në vonesa dhe kosto shtesë për palën tjetër.

6 Procesi i Kyçjes

6.1 Diskutimet Preliminare dhe Studimet e Dizajnit

Aplikuesit ftohen që të kenë diskutime fillestare me **KOSTT** për kyçjet potenciale. Si pjesë e këtyre diskutimeve, **KOSTT** do të ofroj një vlerësim të koston indikative për kyçje potenciale. Këto diskutime preliminare nuk do të formojnë në vete një **Aplikim të Kyçjes**, por do të jenë nën konfidencialitet të plotë. Diskutimet e tilla preliminare do të jenë pa pagesë.

KOSTT normalisht do të kryej **Studimin e Dizajnit** të nevojshëm. Kjo do t'u mundësoj **Aplikuesve** të kuptojnë koston e kyçjes së propozuar pasi që të bëhet **Aplikimi për Kyçje**. **Studimi i Dizajnit** do të ndërmerret në baza kohore dhe materiale. Koha e stafit të **KOSTT-it** do të paguhet në **Taksën për Aplikim**. Në rastin kur **KOSTT** e sheh të nevojshme se duhet mbështetje e konsulencës së jashtme, kjo do të dakordohet me **Aplikuesin** i cili do të paguaj shpenzimet e konsulencës së jashtme.

6.2 Taksa për Aplikim

Taksa për Aplikim caktohet para aplikimit dhe kostoja e saj bazohet në numrin e ditëve të punës dhe **Taksën Standarde**. Shembuj konkret janë paraqitur në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

KOSTT do të publikoj në ueb faqen e vet strukturën aktuale të **Taksës për Aplikim** dhe **Taksën Standarde** për klasë të ndryshme të **Aplikuesve** dhe **Kapaciteteve të Kyçjes** së tyre, që është pjesë e këtij dokumenti.

Nëse gjatë konsultimeve fillestare ndërmjet **KOSTT-it** dhe **Aplikuesit**, aplikacioni konsiderohet të jetë kompleks atëherë zbatohet procesi i tenderimit për të përgatitur **Studimin e Fizibilitetit** konform ligjeve në fuqi të Kosovës. **Studimi i Fizibilitetit** dhe të gjitha shpenzimet tjera administrative do të paguhet nga **Aplikuesi**. Përzgjedhja e ofertuesit do të bëhet nga **Aplikuesi** në bashkëpunim me **KOSTT**.

6.3 Aplikimi për Kyçje

Të gjitha **Aplikacionet për Kyçje** do të trajtohen në bazë të parimit i pari vjen i pari shërbehet. **Aplikuesi** duhet t'i dorëzoj **KOSTT-it Aplikacionin për Kyçje** për kyçjen e Ngarkesës ose Gjeneratorit në Sistemin e Transmetimit, ose të rrisë kapacitetin e kyçjes ekzistuese. Kjo bëhet duke e kompletuar dhe dorëzuar një formë të **Aplikacionit për Kyçje** së bashku me pagesën e **Taksës për Aplikim**.

Aplikimi do të nënkupton fillimin e planit kohor të kyçjes që kërkon nga **KOSTT** të përgjigjet konform **Aplikacionit për Kyçje**, sipas proceseve në vijim:

- **KOSTT** brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të **Aplikacionit për Kyçje** të dorëzuar nga **Aplikuesi**, jep përgjigjen Aplikuesit kundrejt këtij aplikimi.

- **Oferta për kyçje** normalisht do të lëshohet dhe dërgohet tek Aplikuesi brenda 90 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të aplikimit për kyçje. Oferta do të përmbajë datën deri në të cilën kyçja do të përfundojë. Aplikuesi brenda 30 ditëve do të kthej përgjigjen në KOSTT për pranimin ose refuzimin e Ofertës për Kyçje, në të kundërtën procesi i aplikimit për kyçje do të përsëritet nga fillimi.
- Periudha prej 90 ditëve kalendarike për dorëzimin e **ofertave për kyçje** mund të zgjatet në rast të kyçjeve komplekse, që kërkon paraprakisht një studim teknik, ekonomik dhe financiar të zgjerimit të rrjetit ose ndonjë arsye të ngjashme në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodit të Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi. KOSTT brenda 30 ditëve kalendarike pas përfundimit të **Studimit të Fizibilitetit** do t'ia dërgon **Aplikuesit Ofertën për Kyçje**.
- Në rast të ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me kushtet e **ofertës për kyçje**, Aplikuesi mund të bëjë vetë studimin teknik me kostot e tyre. **KOSTT** do të lehtësojë studimin e tillë përmes dhënies së informacionit të nevojshëm.

Afatet e mësipërme janë kufijtë maksimal kohor dhe **KOSTT** do të përgjigjet sa më shpejtë të jetë e mundur për **aplikuesin**.

Kur **Aplikuesi** dëshiron të implementoj kyçjen në disa faza kohore, atëherë **Aplikuesi** mund të vendos të implementoj vetëm fazën e parë me një **Aplikacion për Kyçje** vetëm për atë fazë. Kjo nuk rekomandohet sepse pa dyshim që nuk do të jetë optimale. Më mirë është që:

- Të aplikohet formalisht për fazën e parë dhe me informata për të gjitha fazat përfshirë edhe planin e pritur kohor. Kjo qasje është e përshtatshme kur fazat pasuese janë në varësi të rritjes së kërkesës; ose
- Formalisht të aplikohet për të gjitha fazat me planin kohor të preferuar për komisionimin e secilës fazë. Kjo qasje është e përshtatshme për një termocentral ku generatorët individual do të komisionohen në faza të caktuara të planit kohor.

Nëse **Oferta për Kyçje** pranohet dhe **Marrëveshja për Kyçje** nënshkruhet, **Taksa për Kyçje** duhet të paguhet nga **Aplikuesi** duke përjashtuar **Taksën për Aplikim** e cila paguhet paraprakisht.

6.4 Taksa e Kyçjes

Taksa e kyçjes do të përbëhet prej disa njësive të veçanta (varësisht nga aplikimi për kyçje të thellë apo të cekët):

1. **Taksa për Aplikim**
 - **Studimi i Dizajnit**, vlerësimi për **Koston Fillestare** dhe draftimi i **Marrëveshjes për Kyçje**;
2. **Kostoja Inxhinierike**
 - është kostoja që paguhet nga **Aplikuesi** për **KOSTT**, varësisht prej përgjegjësive dhe aktiviteteve për tenderim dhe ndërtim të **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**
3. **Kostoja e Aseteve të Reja të Transmetimit;**
 - Kostoja e blerjes dhe ndërtimit të **Aseteve të Reja të Transmetimit;**
4. **Kostoja e Përforcimit të Infrastrukturës;**
 - Kostoja e blerjes dhe ndërtimit të **Aseteve për Përforcimin e Infrastrukturës;**

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 18</i>

5. Kostoja për Kompensim dhe Shpronësim;
 - Kosto që ndërlidhet me shpronësimin dhe pagesën për qasje në tokë dhe për dëmet eventuale gjatë implementimit të projektit;
6. Kostot e Mirëmbajtjes;
 - Kostot e ndërlidhura me Mirëmbajtjen e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**.

Taksa për Aplikim (komponenta 1) paguhet me **Aplikimin për Kyçje**. Pagesa e **Kostos Inxhinierike** dhe kostot e Aseteve (Komponenta 2, 3, 4 dhe 5) paguhen ashtu siç është specifikuar në **Marrëveshjen për Kyçje** dhe është parakusht për fillimin e punës. Aplikuesi mund të zgjedh që implementimin e komponentëve 3, 4 dhe 5 të ja besoj **KOSTT**-it ose të ekzekutoj vetë. Në këtë rast standardet që aplikohen janë të njëjtë dhe të definuara në Nenin 4.8 të këtij dokumenti. Tarifa për Mirëmbajtje (Komponenta 6) paguhet në 12 intervale mujore apo një herë në vit.

Lidhur me **Koston Inxhinierike**, **KOSTT**-i mund të kërkoj një depozitë, që nuk tejkalon 10.000€, të kompensohet kur **Aplikuesi** paguan kostot e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës**.

KOSTT ka të drejtë të kërkoj pagesën e detyrimit për anulim (përfundim) të kyçjes, por do të heq dorë nga kjo e drejtë derisa anulimi (përfundimi) të ndodh realisht.

6.5 Taksa për Shërbime

Taksa për Shërbime përfshin kostot për angazhimin e stafit të **KOSTT**, sipas Marrëveshjes bilaterale në mes **KOSTT** dhe Aplikuesit për shërbimet lidhur me procesin e sigurimit të lejeve përkatëse, procedurat për shpronësim/servitut të pronave të paluajtshme, të nevojshme për ndërtimin e asetëve të reja të transmetimit.

Taksa për Shërbime bazohet në numrin e ditëve të punës dhe numrin e stafit të angazhuar nga **KOSTT**. Konkretisht kalkulimi është paraqitur në Shtojcën 4 të këtij dokumenti.

KOSTT do të publikoj në web faqen e vet strukturën aktuale të **Taksës për Shërbime**.

6.6 Oferta për Kyçje

KOSTT do të paraqes një **Ofertë për Kyçje** për **Aplikuesin** brenda Afatit të fundit për Ofertë. Kjo **Ofertë për Kyçje** mbetet e vlefshme për 30 ditë nga dita e dorëzimit tek Aplikuesi.

Oferta për Kyçje duhet të përmbaj:

- Punët e nevojshme për të kyçur një **Aplikues** në rrjetin ekzistues të transmetimit si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim, të emërtuar si “ kyçje e cekët”, siç është përcaktuar në këtë dokument;
- Punët e nevojshme për të kyçur një **Aplikues** në rrjetin ekzistues të transmetimit si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim në rastin kur kërkohet zgjerim ose përforsim në rrjetin e transmetimit, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet të aplikuesit; të definuar si “kyçje e thellë”, siç është përcaktuar në këtë dokument;
- **Taksën standarde** të kyçjes të përcaktuar në pajtim me këtë dokument për aplikuesit që do të furnizohen nga një nivel i caktuar tensioni dhe që bien brenda kufijve të ngarkesës dhe distancës maksimale të caktuar nga rrjeti ekzistues i transmetimit;

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 19</i>

- Të dhënat për instalimin e sistemeve matëse - njehsorëve të përshtatshëm që mundësojnë matjen e energjisë elektrike nga operatori i sistemit, në pikat hyrëse apo dalje;
- Të dhënat për instalimin e ndërprerësve ose pajisjeve tjera sipas kërkesës;
- Të dhënat për instalimin, aty ku kërkohet, të njehsorëve interval me telemetri ose pajisjeve për procesim të të dhënave me qëllim që t'iu mundësoj aplikuesve të cilët janë të detyruar që t'i kenë këto pajisje, për të qenë në përputhje me Rregullat e Tregut
- Rezultatet e studimit të **Dizajnit Fillestar**
- Kapacitetin e Kyçjes
- Datën e Kyçjes
- Palën Përgjegjëse për Kyçje
- **Taksën për Kyçje** që do të paguhet

Kur **Aplikimi për Kyçje** shtrihet në një periudhë kohore të ndarë në faza, **Oferta për Kyçje** do të merr këtë në konsideratë.

6.7 Marrëveshja për Kyçje

Kjo marrëveshje përfshinë:

- Aplikimin për Kyçje
- Ofertën për Kyçje
- Letrën e pranimit të Ofertës për Kyçje
- Studimin e Dizajnit
- **Palën Përgjegjëse për Kyçje;**
- **Kapacitetin për Kyçje;**
- **Datën e Kyçjes;**
- Procesin e kyçjes përfshirë planin kohor
- **Taksat për Kyçje** dhe kushtet e pagesës (nëse është e nevojshme)
- Operimin në vazhdim të kyçjes,
- Kushtet e shfrytëzimit të sistemit.
- Zgjidhjen e kontesteve dhe kushtet e ndërprerjes së marrëveshjes
- Standardet dhe kërkesat minimale të sigurisë, kërkesat në lidhje me vulosjen (bllombimin) e pajisjeve matëse dhe mbylljen me dry të vendit ku janë instaluar ndërprerësit, pajisjet matëse, transformatorët dhe qarqet matëse,
- Detyrimin mbi aplikuesin që të sjell marrëveshjen për shitblerje të energjisë elektrike, para se të bëhen testimet dhe energjizimi i pikës së kyçjes në rrjetin e transmetimit, dhe
- Ndonjë dokument tjetër relevant, që e plotëson Marrëveshjen për Kyçje.

Draft Marrëveshja për Kyçje (në formë elektronike) do t'i bashkëngjitet **Ofertës për Kyçje**. **Marrëveshja për Kyçje** nënshkruhet brenda 30 ditëve pas përgjigjes me shkrim për pranim të **Ofertës për Kyçje** nga Aplikuesi.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 20</i>

6.7.1 Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Kyçje

6.7.1.1 **Marrëveshja e Kyçjes** do të lëshohet për dy (2) vite apo deri në zgjatjen e autorizimit për ndërtim nga **ZRrE**. Nëse brenda kësaj periudhe, **Aplikuesi** nuk fillon procesin e implementimit (ndërtimit) të projektit, atëherë **Marrëveshja e Kyçjes** e nënshkruar nga **KOSTT** dhe **Aplikuesi** do të konsiderohet jo valide dhe procesi do të kthehet në fazën fillestare që nënkupton se **Aplikuesi** duhet të ri-aplikoj për kyçje. **Aplikuesi** brenda periudhës së vlefshmërisë së **MK-së** ka të drejtë të kërkojë para skadimit të afatit një shtyrje prej gjashtë (6) muaj për zgjatje të validitetit të **Marrëveshjes së Kyçjes** duke sqaruar me shkrim arsyen e kërkesës për zgjatje të **MK-së**. Nëse **Aplikuesi** brenda kohës shtesë nuk arrin të filloj projektin, apo nuk ka autorizim për ndërtim të lëshuar nga **ZRrE** procesi kthehet në fazën fillestare dhe **Aplikuesi** duhet të ri-aplikoj për kyçje.

6.7.1.2 **Aplikuesit** të cilët posedojnë **Marrëveshje të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit** të lëshuar para hyrjes në fuqi të amendamentimit të kësaj Metodologjie, do të trajtohen sipas **Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit** (Versioni 2.9) të aprovuar nga Bordi i **ZRrE-së**, me Vendimin V_1015_2018 të dates 12.07.2018, dhe do të mbesin në fuqi të pandryshuara.

7 Çështjet e Implementimit

7.1 Trajtimi i barabartë

Në pajtim me Licencën e OST të gjithë **Aplikuesit** do të trajtohen në baza jo diskriminuese. Kjo metodologji diferencon parimet e taksës së aplikuar për Gjenerim dhe taksës së aplikuar për Ngarkesë, si kategori të ndryshme të **Aplikuesve**, kurse klasa e njëjtë e **Aplikuesit** do të ketë trajtim të barabartë sipas dispozitave të kësaj metodologjie dhe dokumenteve tjera ligjore.

7.2 Konfidencialiteti

I gjithë komunikimi ndërmjet një **Aplikuesi** dhe **KOSTT** është tërësisht konfidencial. **KOSTT** nuk do të diskutoj çështjet me palët e treta përveç nëse merr leje me shkrim nga **Aplikuesi**. Kjo përfshinë edhe **Aplikuesit** tjerë, aplikacionet e të cilëve janë dorëzuar afërsisht në kohë të njëjtë dhe për pozitën e njëjtë në rrjet.

ZRrE mund të jetë e përfshirë në çfarëdo kohe gjatë procesit të kyçjes, nga aplikimi deri në komisionimin e kyçjes.

7.3 Refuzimi për Kyçje

KOSTT do të mund të refuzoj një kyçje vetëm nëse ka arsye teknike për një gjë të tillë, siç përshkruhet në Kodin e Rrjetit – Kodin e Kyçjes dhe kodet tjera teknike. Duke pasur parasysh se **Aplikuesi** duhet të paguaj paraprakisht, nuk duhet të ketë asnjë arsye financiare për refuzim.

7.4 Dështimi i Kyçjes

Cilado palë (përfshirë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes) që dëshiron një **kyçje të re** në Sistemin e Transmetimit duhet që paraprakisht të paguaj **Taksën e Kyçjes**. Prandaj nuk ka rrezik direkt për **KOSTT** nëse projekti nuk përfundon dhe kyçja mbetet e pa shfrytëzuar.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 21</i>

Nëse projekti anulohet në gjysmë të procesit të ndërtimit disa kosto mund të kursehen duke e ndaluar punën e mëtutjeshme. Për më shumë nëse asetet të cilat janë blerë mund të ripërdoren do të ketë zbritje kur ato të ripërdoren.

7.5 Përforcimi i Kyçjes (Rritja e kapacitetit)

Përforcimet apo rritjet e kapacitetit të një pike të kyçjes apo aplikimi që ndodhet në proces të shqyrtimit trajtohen si në vijim:

- Kur ngarkesa tejkalon 3% të **Kapacitetit Efektiv Ekzistues, KOSTT** do të kërkoj nga shfrytëzuesi që të zgjeroj kapacitetin e pikës së kyçjes, përmes procedurave përkatëse për aplikim.
- Në rastet kur një **Aplikues** menjëherë pasi që ka realizuar Aplikimin për kyçje dhe deri në fazën e implementimit të projektit kërkon ndryshimin e kapacitetit të kyçjes në vlerë më të madhe se 3% të kapacitetit të parashtruar në Aplikacionin aktual (i cili është në proces të analizës), atëherë procesi ndërpritet dhe fillon procesi nga fillimi, që nënkupton se **Aplikuesi** do të procedoj Aplikacion të ri për kyçje.
- Çdo aplikim për një rritje të kapacitetit të pikës së kyçjes që është më e madhe se përqindja e lartcekur do të konsiderohet si kyçje e re dhe do të aplikohen procedurat relevante për kyçjet e reja për diferencën.
- Në rastet kur **Aplikuesi** në **Aplikacionin për Kyçje** kërkon që kapaciteti i linjave elektrike apo çfarëdo pajisje tjetër elektrike të jetë më e madhe se kapaciteti i tërësishëm i njërive gjeneratorike apo i ngarkesës bazë, atëherë **Taksa për Aplikim** do të dizajnohet në bazë të kapacitetit të linjave elektrike apo pajisjeve tjera elektrike.

Përforcimet e imponuara nga sistemi do të iniciojnë taksa të reja. Nëse një gjenerator kyçet afër lokacionit të përforcuar dhe nivelet e prishjeve ngriten ashtu që ndërprerësit ekzistues nuk janë më të sigurtë, **Shfrytëzuesi** i ri do të përforcoi ndërprerësit e vet dhe do të paguaj për përforcimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit**.

7.6 Asetet e Paguara nga Donatorët

Kur **Asetet e Reja të Transmetimit** paguhen nga donatori, këto do të trajtohen si pjesë e sistemit kryesor të transmetimit të **KOSTT**.

Kjo do të thotë se **KOSTT** do t'i rikuperoj shpenzimet të ndërlidhura me këto asete nëpërmjet Tarifës SHST.

7.7 Kompensimi

Nëse një **Aplikues** brenda periudhës 15 vjeçare (nga data e futjes në operim të aseteve) dëshiron të kyçet në **Asetet ekzistuese të Transmetimit**, ose të shfrytëzoj **Asetet e Përforcimit të Infrastrukturës** fillimisht të financuara nga shfrytëzuesi ekzistues, atëherë **Shfrytëzuesi** ekzistues do ketë të drejtë në kompensim (kthim) nga **Aplikuesi**.

Ky kompensim (kthim) duhet të jetë proporcional me pjesën e aseteve të kyçjes ekzistuese që synohen të shfrytëzohen nga **Aplikuesi**. Gjatë kalkulimit të kompensimit, **KOSTT** do të merr parasysh këto kondita:

- Koston origjinale të Aseteve ekzistuese

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 22</i>

- Zhvlerësimin e Aseteve ekzistuese
- Indeksimi vjetor i kostos së asetëve sipas Indeksit të çmimeve të konsumit
- Ndarjen proporcionale sipas kapacitetit maksimal në MW të **Aplikuesit**

Procesi i kompensimit nga **Aplikuesi** tek **Shfrytëzuesi** ekzistues do të realizohet përmes KOSTT.

7.8 Anulimi (Përfundimi) i Kyçjes

Kur një **Shfrytëzues** kërkon të anuloj Marrëveshjen e Kyçjes ai duhet të njoftoj **KOSTT**-in një vit më herët.

KOSTT ka të drejtë në pagesë për punët e nevojshme inxhinierike që të mbaj të sigurt lokacionin e pajisjeve përkatëse.

7.9 De-energizimi (deaktivizimi) i kyçjes dhe Dekomisionimi

De-energizimi i kyçjes, përfshirë izolimin dhe mbylljen, nuk llogaritet si anulim (përfundim) i Marrëveshjes për Kyçje.

Kur **Shfrytëzuesi** de-energizohet për shkak të dështimit të paguaj ose për mos pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit, Marrëveshja e Kyçjes mbetet në fuqi përfshirë Tarifat SHST dhe tarifën për mirëmbajtje.

Shfrytëzuesi mund të kërkoj që të de-energizohet për një periudhë të caktuar pas **Datës së Kyçjes**. Kjo kërkesë do të zbatohet, por Shfrytëzuesi edhe më tutje do të obligohet për ndonjë SHST të papaguar si dhe për tarifën për Mirëmbajtje derisa ZRrE të vendos që kjo tarifë të paguhet përmes tarifave SHST. De-energizimi i kyçjes do të bëhet pa ndonjë kosto kundrejt **shfrytëzuesit** për këtë shërbim.

Përgjegjësia për dekomisionimin e **Aseteve të Reja të Transmetimit** do të caktohet me marrëveshje ndërmjet palëve. Me kërkesë të **Shfrytëzuesit** mund të jetë KOSTT përgjegjës për dekomisionimin e këtyre Aseteve. Gjithsesi pala përgjegjëse për të gjitha kostot që rrjedhin për procesin e dekomisionimit të këtyre asetëve do të jetë **Shfrytëzuesi**. Nëse KOSTT do të jetë pala përgjegjëse për dekomisionim, atëherë procesi do të shkoj përmes një tenderi të hapur dhe transparent (me pjesëmarrjen e **Shfrytëzuesit**) ku do të zbatohen të gjitha rregullat e prokurimit publik.


Dekomisionimi i **Aseteve të Reja të Transmetimit** nuk mund të bëhet derisa Marrëveshja për Kyçje është në fuqi.

7.10 Ankesat


Aplikuesi ka të drejtë të ankohet në ZRrE për **Ofertën për Kyçje** sipas “Rregullës për Zgjidhjen e ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë”.

Shtojca 1:

a) Shembull i Kompensimit



b) Shembulli i Kyçjes së Thellë



Shtojca 2: Forma e Aplikacionit për Kyçje

FORMA E APLIKACIONIT PËR KYÇJE – NGARKESË “N”

Kur të përfundohet dërgoje këtë aplikim te:

Personi kontaktues¹

KOSTT

Rr. Isa Boletini nr.39

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Aplikuesi	
Personi kontaktues	
Kontakt detajet e Aplikuesit	
Lokacioni i propozuar i nënstacionit <i>Bashkëngjit hartën e lokacionit</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
Numri i propozuar i transformatorëve <i>Bashkëngjit skemën e planimetrisë së propozuar të nënstacionit</i>	
Ngarkesa maksimale për tu furnizuar (MW) brenda 10 viteve nga koha e kyçjes	
Faktori maksimal i ngarkesës induktive dhe i ngarkesës kapacitive	
Pala Përgjegjëse për Kyçje	
Ju lutem paraqitni informatat relevante teknike si kërkohet në Kodin e Rrjetit	
Ju lutem paraqitni informata tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në studimin e dizajnit	
Bashkëngjitur pagesa për Taksën e Aplikimit	

¹ Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me Aplikacionin për Kyçje ju lutem kontaktoni personin kontaktues



Unë i poshtë shënuari me këtë konfirmoj se të gjitha informatat e paraqitura më lartë janë të sakta në bazë të njohurisë time më të mirë. Unë do të njoftoj **KOSTT** për çfarëdo ndryshimi të madh të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për atë.

Aplikuesi

Emri dhe Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

FORMA E APLIKACIONIT PËR KYÇJE – Gjenerimi “G”

Kur të përfundohet dërgoje këtë aplikim te:

Personi kontaktues²**KOSTT**

Rr. Isa Boletini nr.39

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Aplikuesi	
Personi kontaktues	
Kontakt detajet e Aplikuesit	
Lokacioni i propozuar i nënstacionit <i>Bashkëngjit hartën e lokacionit</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
A është kërkesa për kyçje në faza <i>Bashkëngjit detajet e planit kohor</i>	
Tipi i Karburantit	
Nëse është Hidro bashkëngjit detajet e plota hidrologjike Nëse është me Erë bashkëngjit informatat meteorologjike Nëse është me diell bashkëngjit informatat meteorologjike	
Numri i propozuar i gjeneratorëve dhe madhësitë (MW) <i>Bashkëngjit skemën e planimetrisë së nënstacionit</i>	
Gjenerimi maksimal (MW)	
Gjenerimi maksimal stabil (MW)	
Maksimumi i MVA dhënje dhe MVA marrje	
Pala Përgjegjëse për Kyçje	
Ju lutem paraqitni informatat relevante	

² Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me Aplikacionin për Kyçje ju lutem kontaktoni personin kontaktues



teknike si kërkohet në Kodin e Rrjetit	
Ju lutem paraqitni informata tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në studimin e dizajnit	
Bashkangjitur pagesa për Taksën e Aplikimit	

Unë i poshtë shënuari me këtë konfirmoj se të gjitha informatat e paraqitura më lartë janë të sakta në bazë të njohurisë time më të mirë. Unë do të njoftoj **KOSTT** për çfarëdo ndryshimi të madh të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për atë.

Aplikuesi

Emri dhe Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 28</i>

Shtojca 3: Taksa për Aplikim, Taksa Standarde dhe Kostoja Inxhinierike

Tabela e mëposhtme tregon shembujt tipik të numrit të ditëve të nevojshme për procesimin e aplikimit për kyçje në Sistemin e Transmetimit.

Nr.	Lloji	Fuqia në MW	Numri i ditëve
1.	Ngarkesë	≤20	8
		>20 dhe ≤100	12 ose (*)
		>100	(*)
2	Gjenerator	≤ 20	12
		>20 dhe ≤100	20 ose (*)
		>100	(*)

*paraqet studimin e nevojshëm të fizibilitetit, kostoja e të cilit përfshinë çmimin e kontraktuar + taksën administrative

Numri i pritur i ditëve është i përafërt dhe është i varur nga lokacioni dhe kompleksiteti i kyçjes. Numri aktual i ditëve të punës do të tarifohet me **Taksën Standarde** duke përfshirë edhe punën në terren.

Taksa Standarde është taksa që kalkullohet në baza ditore prej 70€ për ditë pune.

Taksa për Aplikim do të llogaritet si më poshtë:

Taksa për Aplikim = **Taksa Standarde** x numri i ditëve të punës.

Kostoja Inxhinierike do të kalkullohet si më poshtë:

- 1.5% e koston së **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** kur **Aplikuesi** është **Pala Përgjegjëse për Kyçje**
- 5% e koston së **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** kur **KOSTT** është **Pala Përgjegjëse për Kyçje**

Shembull:

Aplikacioni për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit.

Lloji i kyçjes është Ngarkesë me kapacitet prej 80 MW dhe kostoja finale për implementim e **Aseteve të Reja të Transmetimit** dhe sipas nevojës edhe të **Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës** do të kushtoj 2 mil € atëherë:

Taksa Standarde = 70 €

Taksa për Aplikim = 70 € x 12 ditë pune= 840 €

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 29</i>

Nëse **Palë Përgjegjëse për Kyçje** është **Aplikuesi**:

$$\text{Kostoja Inxhinierike} = 2\,000\,000 \text{ €} \times 0.015 = 30\,000 \text{ €}$$

Nëse **Palë Përgjegjëse për Kyçje** është **KOSTT**:

$$\text{Kostoja Inxhinierike} = 2\,000\,000 \text{ €} \times 0.05 = 100\,000 \text{ €}$$

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit	DT-KO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 30</i>

Shtojca 4: Taksa për Shërbime

Taksa për Shërbime = **Taksa Standarde** x numri i ditëve x numri i personave të angazhuar.

a) Shembull i kalkulimit të taksës për shërbime

Konsiderojmë që Linja e tensionit 110kV e cila është pjesë përbërëse e Aseteve të Reja të Transmetimit është e gjatësisë 10 km dhe procesi i sigurimit të lejeve përkatëse, shpronësimi/servituti, etj për këtë aset ka marrë një kohë prej 80 ditë pune, atëherë Taksa për Shërbime do të kalkulohet si në vijim:

Taksa për Shërbime = 70 € x 80 ditë pune x 4 persona= 22400 €

Taksa për Shërbime paguhet sipas procesit bazuar në dispozitat e caktuara në Marrëveshjen bilaterale për shërbime (KOSTT – Aplikuesi).

Shtojca 5: Kostot indikative për Asetet e Reja të Transmetimit dhe Aseteve Përforcuese të Infrastrukturës te mundshme

Vlerësimi i kostos për Asetet e Reja Transmetimit		
Objekti	Njësia	Çmimi njësi € (pa tvsh)
ATR 300 MVA, 400/115 kV	cope	3,200,000.00
ATR 150 MVA, 220/115 kV	cope	1,500,000.00
ATR 31.5 - 40MVA	cope	500.000 deri 700 000
LP 400 kV - i njëfishtë, 490/65 mm ² , ACSR	km	350,000.00
LP 400 kV - i dyfishtë, 490/65 mm ² , ACSR	km	520,000.00
LP 220 kV - njëfishtë, 360/57 mm ² , ACSR	km	170,000.00
LP 220 kV - dyfishtë, 360/57 mm ² , ACSR	km	250,000.00
LP 110 kV - njëfishtë, 240/40 mm ² , ACSR (me OPGW)	km	120,000.00
LP 110 kV - dyfishtë, 240/40 mm ² , ACSR(me OPGW)	km	160,000.00
LP 110kV - e njëfishtë nëntokësore - kablli (tri faza)	km	370,450.00
LP 110kV - e dyfishtë nëntokësore - kablli (tri faza)	km	420,000.00
Fusha e linjës LP 110kV komplet me pajisjet (Ndërprerësi, Ndarësat mbrojtjet rele, izolatorët, shkarkuesit e mbitensionit, tokëzimi)		400,000.00
Fusha transformatorike 110kV (Ndërprerësi, Ndarësat mbrojtjet rele, izolatorët, shkarkuesit e mbitensionit, tokëzimi)		400,000.00
Fusha transformatorike 35kV		76,605.70
Sistemet matëse		110,000.00
Sistemi i telekomunikimit		100,000.00
Sistemi i SCADA-s		250,000.00

(Fund i dokumentit)